



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 254, Datë 21.12.2021

MBI

**LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 206, DATË 16.12.2019,  
“MBI MIRATIMIN E TARIFËS SË PËRKOHSHME TË TRANSMETIMIT TË GAZIT  
NATYROR NGA SHOQËRIA “ALBGAZ” SH.A.” PËR VITIN 2022**

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, të nenit 13, pika 1, nenit 16, pika 2, neni 17, gërma “e” dhe neni 33, të ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar; nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Metodologjisë për llogaritjen e tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 178, datë 18.11.2017; bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 21.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 156/10 prot., datë 17.12.2021, e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., për vitin 2022”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 60, datë 15.04.2019, vendosi “Miratimin e përkohshëm të tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a., prej 28 lek/m<sup>3</sup> ose 2.6457 lekë/kwh deri më 31.12.2019”.
- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, është miratuar lënia në fuqi e vendimit të bordit të ERE-s nr. 60, datë 15.04.2019, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a. për vitin 2020”.
- Në zbatim të pikës 1, të nenit 21, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, dhe pikës 1, të nenit 17, të “Metodologjisë për llogaritjen e tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 78/2017, Operatori i Transmetimit të Gazit Natyror duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim për miratimin e tarifave të reja në ERE, të shoqëruar me gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar sipas kësaj rregullore dhe metodologjive përkatëse.

- ERE me shkresën nr. 987 prot., datë 04.10.2021, me lëndë: “Kërkesë për informacion”, i është drejtuar shoqërisë “Albgaz” sh.a. që të marri masa për përmbushjen e detyrimeve, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Shoqëria “Albgaz” sh.a. me shkresën nr. 138/1 prot., datë 01.12.2021 (me tonën nr. 987/1 prot., datë 01.12.2021) u përgjigj ndaj kërkesës së ERE, ndër të tjera duke kërkuar që për vitin 2022 të mbetet në fuqi tarifa aktuale e transmetimit.
- Tarifa e shërbimit të transmetimit të gazit natyror është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit nga shoqëria “Albgaz” sh.a., i cili ushtrohet konform ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, si dhe direktivave të Komunitetit të Energjisë, ku aksesimi në rrjet për përdoruesit e sistemit të transmetimit duhet të jetë i garantuar dhe kjo shoqëri duhet t’i ofrojë shërbimet e saj me tarifa të rregulluara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, të bordit të ERE-s për vitin 2022, deri në miratimin e një tarife të mbështetur në aplikimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a.
2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e kërkuara të shoqërisë “Albgaz” sh.a. nga të ardhurat e kërkuara të përkohshme, do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre sipas përcaktimeve të nenit 17, gërma “e”, e ligjit nr.102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar.
3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**